

VENDIM
Nr. 172, datë 3.8.2018

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “URADRIN” SHPK, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE, nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.8.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut për licencimin e shoqërisë “URADRIN” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 455, datë 15.6.2018, shoqëria “URADRIN” sh.p.k., ka paraqitur në ERE kërkesën për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 153, datë 3.7.2018, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë “URADRIN” sh.p.k. në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me shkresën nr. 55/48 prot., datë 3.7.2018, u bë njoftimi në median e shkruar si dhe me shkresën nr. 455/1 prot., datë 11.7.2018, iu kërkuar subjektit të plotësojë dokumentacionin e munguar i cili konsiston në vërtetimin e prokurorisë.

- Subjekti “URADRIN” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 455/3 prot., datë 17.7.2018, paraqiti në ERE dokumentacionin e munguar.

- Në përfundim të afatit 10 ditë pune, të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.6.2016, nuk rezultoi të ketë ndonjë vërejtje apo ankesë nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria “URADRIN” sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “URADRIN” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionin teknik për aktivitetin tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “URADRIN” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti